

20141775472

LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13 dhe 106/13) pas nenit 99 shtohet titulli i ri dhe neni i ri 99-a si vijojnë:

“Ndhima shtesë për produkte bujqësore

99-a

Qeveria mund të miratojë vendim për ndihmë shtesë si masë për pagesë të produktit të caktuar bujqësor shuma e të cilit nuk mund të jetë më e madhe se çmimi mesatar për blerje për atë produkt në rajonin prodhues sipas njësisë matëse.

Mjetet për ndihmën shtesë nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jenë të pakthyeshme ose të kthyeshme dhe të kthehen më së voni në afat prej tri vitesh nga dita e pagimit të tyre.

Në vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni do të përcaktohet lloji i produktit bujqësor, lartësia e ndihmës shtesë për atë produkt në pajtim me kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni si dhe mënyra e përcaktimit të shumës dhe afatit për kthimin e mjeteve të paguara për ndihmë shtesë.

Ndhima shtesë nga paragrafi 1 i këtij neni do të paguhet nëpërmjet Agjencisë për Përkrahje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural si masë e paraparë në programin vjetor për përkrahje financiare në bujqësi.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.